

M e h m e t B i s l i m i

I R O N I E V E R D H Ë
(riboitim)

Mehmet Bislimi

IRONI E VERDHË

Redaktor:
Ismail SYLA

Recensent:
Kadri REXHA

Ballina dhe faqesja:

albdesign
www.albdesign.ch

Copyright © 2005 Autori dhe botuesi

M E H M E T B I S L I M I

I R O N I E V E R D H Ë

Prishtinë 2005

P O E Z I

Me dëshirë kam dhënë më shumë për ju
Ulur pranë oxhakut të vjetër
Drejt amshimit me shpirt të lehtësuar
S'do marrim as gjë në botën tjetër...

- Autori

Fjala e redaktorit

Poezitë e librit “Ironi e verdhë” të poetit dhe publicistit Mehmet Bislimi përshkohen me një pezëm të artikuluar artistik që fund e krye i përshkon filli i fortë i ironisë. Janë poezi të shkruara në kulmin e moshës së autorit, në kulmin e pjekurisë, dhe si të tilla reflektojnë ndjeshëm kredon e autorit për jetë me tërë larushinë e saj. Fushat ku prek ironia janë pamjet e përgjithshme të individit dhe mileut të tij. Poezitë e Mehmet Bislimit nuk janë versioni lirik i zhgënjimit të tij, përkundrazi janë shpërthime të mllëfit të disiplinuar artistikisht. Kështu përkufizohet vreri i ironisë së tij. Rebelizmi optimist, sarkazmi i skajshëm, gjuha e zhveshur dhe emërtuese e drejtpërdrejtë e devijimeve të padurueshme artikullohet në korpusin themelor të librit poetik pa keqardhje dhe pa pardon. Zbrazja lirike e autorit është një manifest ironik për kohën nëpër të cilën shoqëria pluskon midis vlerave dhe pseudo vlerave, ndërthurja e të cilave krijon përshtypje mikste, dhe është e vështirë të dallohet natyra e vërtetë e gjërave. Sido që të jetë, autori i ka të qarta fijet e mbështjella dhe pleksura gabimisht, dhe nuk është e vështirë të krijohet çmpleksja e tyre. Në fund të fundit, psikologjia dhe ecja nëpër rrugën e rëndë të tranzicionit të një kombi, duhet të zërë vende edhe në arte, edhe në poezi. Një dimension i dhënë suksesshëm me figurën e ironisë është padyshim ai i librit “Ironi e verdhë” i autorit Mehmet Bislimi, që lexuesi tanimë e ka në dorë.

Ismail SYLA- kritik letrar

Fjala e recensentit

Librin me poezi me titull:” Ironi e verdhë” të poetit Mehmet Bislimi, e lexova me një kënaqësi të veçantë, dhe si thonë me një frymë! Libri ka dalë mjaftë i mirë. Si titulli ashtu edhe ballina e librit të cilat përfaqësojnë besnikërisht përmbajtjen dhe mesazhin e poezive. Nivel të lakmueshëm shprehës autori ka arritur sidomos me poezitë ironike, të cilat në shumë raste arrijnë deri te sarkazma. Ky lloj i poezisë tek ne është deficitar sepse poetët tonë më shumë imagjinojnë se sa që merren me realitetin shoqëror, me jetën konkrete dhe me problemet e saj. Në fund të fundit shtrohet edhe një pyetje: sa e njohin shkrimtarët tanë realitetin dhe shpirtin e shumëvujtur të shqiptarit, dëshirat, kërkesat, veset, ambiciet, pasionet...? Përvoja jetësore e autorit, intuïta e trashëguar e mjedisit ku ai jetoj dhe u rritë, preokupimi i tij shumëvjeçar për çështjen kombëtare, mospajtimi konkret me robërinë individuale dhe kolektive, pjesëmarrja e tij në rezistencën shqiptare kundër okupatorit dhe kolonializmit serb, përjetimet e tij dhe të shokëve të tij burgjeve

të okupatorit serb, anëtarësimi dhe roli udhëheqës i tij në frontin e luftës, të gjitha këto janë një bagazh i pasur, sa i hidhur po aq edhe i ëmbël, që autorin e kanë ndihmuar t'i kapë fenomenet në esencë, në rrënjë... Një krah të fortë ndihme në vokacionin e tij poetik e ka edhe nga krijimtaria gojore e popullit tonë e në mënyrë të veçantë nga anekdota aq shumë e kultivuar sidomos në trevën e Drenicës dhe të Dukagjinit. Libri poetik "Ironi e verdhë", është voluminoz dhe shquhet me një larmi temash ekzistenciale të kombit tonë në një kohë epike, me të gjithë heroizmat dhe ligësitë e saj.

Poetit dhe publicistit, Mehmet Bislimit i uroi punë të më tejme në lëmin e krijimtarisë poetike dhe publicistike, suksese të reja në të ardhmen!

Kadri REXHA- letrar

EPIKË E PËRFLAKUR

Emblemë

(Adem Jashari)

Toka të nxori nga gjiri
Trung i lashtë Ilirie
Nga gjiri të nxori
Në gji të mori
Legjendë e gjallë
Emblemë përjetësie

Ishull

Rrethuar me ujëra të turbullta
Burrëri e lagur
Ndër vite Kosovë
Përgjakur

Ishull i robërisë
Lagështi që s'të kalbi
S'të ndryshku

Lumenj gjaku Kosova ka
Ujë
S'ka

Prizmi i dyshimit

Mes shkëlqimit dhe rënies
Ndershmëria në provë
Kambanat po ndjellin
Mort pikëllim zhgënjim

Permanencë vizuale
Nën prizmin e dyshimit
Të vdekurit i vunë

Tradhtinë vari

(Hamëz Jashari)

Te lisat e Prekazit
Tradhtinë vari

Albulenë
Myku eshtrat t'i ka ngrënë
Tradhtinë myku
Nuk e zuri
Me litar në fyt
Gjashtëqind vjet erë myk
He na plaçin
Sytë

Në ballë të oxhakut

(Shaban Jashari)

Në galerinë e një portreti
Pushka
Qelibari
Kuti e duhanit
Si dikur

Në ballë të oxhakut
Kushtrimi

“Toka nuk na pranon të robëruar!”...

Rrugët

Nëse na i mbyllin rrugët
Ne do hapim shtigjet

Kot
Diellin nuk mund të na e zënë
Të ligjtë

Ata që rrugët bëjnë
Shtigjet hapur lënë

Flakët

Sonte
Flakët e lirisë në Prekaz
Komandantin kujtojnë

Për ty atdhe
Flakët
Që të mos shuhen kurrë
Po i mbajmë në gji
Flakët e lirisë
Në të gjatën udhë
Komandant

Dilemë

Punoi për të tjerët
Veten shau
Punoi për vete
Të tjerët e shanë

Kur vdiq
E shanë dhe e qanë
Sharje dhe qarje aksidentale
Si nuk u ringjall Isai - Jezu
Shfryrjet e pelegrinëve
Mbi pavdekësinë
T'i ndiejë

Pikëpyetje

Ata ia bënë atdheut atë punë
Nga gjithë ai nam i zi
Vetëm një pikëpyetje mbeti
Diku
Me ligjin masturbuan

Kundër atyre
As sot
Qoftë edhe një pikëpyetje
A pikëçuditje
Diku
Nuk e vunë
Me moralin masturbuan

Një pëllëmbë truall

Kërkojnë një pëllëmbë truall
Për Legjendarin
Truall në Prishtinë
Sa për të vënë këmbët
Mbi dhe

Dëshmorët
Presin përgjigje

Fehmi Lladrovci

Secili kishte diçka për të thënë
Secili
Në mënyrën e vet
Heshtja po ndrydhte
Dikë më rëndë
Fjalët në grykë na kishin mbet

E kujtonim Komandantin
Shokun e dashur Fehmi
Secili me fjalët e bukura
Të paktë
Të pakt me shembullin e tij

UNIVERSI NË KORNIZË

Kryqëzim

Si rezultat i kryqëzimit
Erdhi në jetë
Stili i rrëfimit
Për mëkatet e pabëra

Të pafajshmit në kryq i gozhduan
As sot
Nuk u penduan

Kryqëzatat pollën
Imagjinatën e udhëkryqeve
Qëllimi dhe mjetet s'u kursyen
Në emër të Perëndisë
Botën e futën në paudhësi

Egërsi e kryqëzimit të lashtë
Pikturën e gjakut
Para botës
E solli në ekspozitë

Me peshën e saj
Nga lashtësitë

Shkëlqimi që vret

Të vetmin që do ta vriste shkëlqimi
I hënës gënjeshtare
Ishte ai

E kisha vënë re
Ka herë
Yshtur pas hënës së kuqe
Që iku në të parin agim
Shpresoj mos të të vras
Ndjenja e trishtimit
Në kuqësinë tënde

Shtegu

Bëmë shumë
Që dëshirat të kalojnë
Nëpër shteg më lehtë

Mos i mbyllni shtigjet
Lini hapur edhe për të tjerët
Në këtë jetë
S'jeni vet

Muralet

I hoqën më parë
Se ç'i vunë
Muralet
Pasuesit fatal të popullit
Futur aksidentalisht në lojën e madhe
Të kombit

Muralet
Mbuluar me ferexhe
Lojë me historinë
Deri në trishtim
Përfaqësuesit e platformës neveritëse
Netëftohave të dimrit
Në peshim

Rigjykim

Me tërë peshën e vet
Dheu rëndon
Për t'i liruar
Çlirimtarët
Nga jargët e hienave

Peshën e dheut dikush
Kërkon

Skelete të pa kompletuara
Tretur baltërave
Të gadishullit Ilirik
Kur do t'ju nxjerrin
Para trupit gjykues
Për fajet që nuk i keni bërë
T'ju dënojnë pas vdekjes
Edhe një herë

Më rëndë se dheu
Diçka peshon

Rimat

Në vargje
Në rrugë
Në jetë
Rimat të përcollën

Korbat vallëzojnë
Emil Zola
Po tallen me ty sot
Mbrojte rimat nga turpi i kohës
Turpi djersinë

Nga tmerri
Rimat çakorduar
Që nga Drajfusi e këtej
Simbol i sublimitit

Nihilisti

Për nder të atyre që ranë
Mos pështyni në rrugë

Pështyjeni nihilistin në surrat

Po e takuat diku
Në rrugën e Dëshmorëve
Në rrugën
E larë me gjak

Uji

Ndrydh e shtrydh
Shtrydhe e ndrydh
Uji gjak nuk bëhet

Ethshëm po punojnë
Ekspertët e natës që gjakun
Ujë ta bëjnë
Damarët Kosovës t'ia thajnë

Në Ibrin e ngrirë kristal
Egzoni me shokë
Natën e gjatë kuqëzoi
Prishtinë e trëndafilave
Gjaku ujë s'u bë

Plaku

(Xh. Gashit – Plakut)

E përbuzi të djeshmen
Me vdekjen u tall
Në përqaftim të së nesërmes
Amshim
S' ishte futur rastësisht
Në shërbim të atdheut
Prandaj rrugëtoi
Qetë e vertikalisht
Plaku

Dhuna

Lirinë e dashuruan
Qielli u mbars
Në jetë solli
Frytin liridashës

Për tokën
Ranë dalzotësit e saj
Deri dje
Pa zot

E sot

Kufiri

Ma gjeni kufirin
Mes
Dashurisë dhe urrejtjes
Gënjeshtërs dhe të vërtetës
Moralit dhe imoralitetit
Mjerisht sot aktual

Më duhet patjetër
Dikujt
Kufirin t'ia tregoi
Seriozisht t'i themi
Ndal

Dëshirë

Dëshiron për të qarë
E loti nuk të vjen
Dëshiron të qeshësh
E qeshura nuk të zënë
Vdekja nuk të merr

Jetë hequr padrejtësisht e zvarrë
Si hardhuca e përhirtë
Mbi bezen e bardhë

TRISHTIMI I SHEKUJVE

A do karrocë zotëri

Hipotekë e mjerimit
Shtrirë në shekuj
Bijtë e shekullit të ri
Në tregun e blertë të Prishtinës
Strukur nën lotin e shiut

Shpresa të mekura në zërin e një fëmije
Që thërret në refren
I ndjenë

A do karrocë zotëri

Te tregu i blertë i Prishtinës
Jo larg spitalit të veremit
U dogj në mjerim poema
Dhe mushkëri e Migjenit

A do karrocë zotëri

Katarsis

E pabesueshme
Kaq shumë pastrim u dashka
Në këtë krizë
Me reduktime uji e rryme
Vështirë se
Pastrohet ndërgjegjja

A ka lumë që na lanë

Se dy sharje ka
E ty të laftë gjaku
As lumi mos të laftë

Daullja

Mbi kë do të bie rrufeja
Nga jonet në fërkim
Bërrylagjinj provincial
O pranverë e ftohtë
Me qiellin bubullimë
Anatemuesin more
Psikologji e argalisur
Dehur nga daullja
Mbi plancin përplasur

Dy lek
Darka e lavdërimit
Katër lek
Procesi fiziologjik i lirimit

Ekonomi deficitare
Ta mbash a ta hash
Do thoshte Shekspiri

Divorcimi

Dy gjenerata

Përjetësisht të divorcuara
Për hir
Të besnikërisë
Të tradhtisë
Ndaj dhe kundër
Atdheut

Heshtje

O heshtje në fund
Të fillimit
Eufori e krimin
Mbi varre zbrazur
Rrëqethur pikëllimi

Skelete te një kombi të pa identitet
Shëtisin lakuriq
Me pasaporta diplomatike
Edhe sa mandate
Në Bruksel
Kosovën do të përfaqësoni
Skelete të rebeluara
Ç' trishtim

Përballim

Simbol i përtëritjes
Krenari adhuruese
Duku

Tokë me zjarre mbuluar
Gjeografi me varre
Qe tmerron

Vdekje ulur këmbëkryq në Kosovë
Yshtur pas hapi të lodhur
O njerëz
Me zemër të grisur
Ndrydhur mes mureve të jetës
Lirinë e bartur
Në trastën e shpresës

Mallkimi ynë ka për t'i zënë
Ata që krenarinë
E ecjeve
Drejt rilindjeve vranë

Gjeografi e hapësirave
Shqiptare
Përballëve dhimbjet krenare

Vrasje e trishtimit

Ritual i përditshmërisë
Venitur deri në banalitet

Rrugë tjetër nuk kishte mbetur
Mes dhimbjes dhe
Vullnetit për rimëkëmbje
Gdhiu pushka e lirisë ndër male
Rrugë e kahmotpritur
Që vrau ndjenjën e trishtimit
Me pushkën
E Altinit

Projekt

Përcjellësi i fundshekullit të kaluar
Dhe pritësi i këtij fillim shekulli
Krijuan marrëzitë
Me projekt
Qe të mos kthehet lumi më
Tek burimi i vet

Kaq thellë qenke fshehur
Fshehtësi
Në gjirin e tokës
Marrëveshje morale mbi enigmën
Toka- hiri- Jeta- gjaku

Gjyshërit në gjykim
Tmerri psikologjik
Qetësinë gënjeshtare vret
Për mundin e gjyshërve në pendim
Çka nuk polle
Atdheu im

Pa dashje

Ja këputa telin çiftelisë
Pa dashje
Nuk ia mësova notat e melodisë
Kurrë

E melodinë desha aq shumë
Djalli ta marr

Për ty më këngë
Nuk do të këndohen
As vaj s'do bëj kush

Vrave këngë me dorën tënde

Në rrugën e harrimit të thanë
Kujdes këngën se vritet

Burrëri

Burra
Ka
Ka pasur
Do të ketë

Kryefjala dhe kallëzuesi

Burri
Nuk liget dhe
Në pusinë e ligësisë
Nuk bie

Ura

Kërkohen ura...

Nën ura fqinjët
Tinëzisht futur janë
Pabesisht
Urat përdhunuar kanë
Tmerrësisht

Urat
Na kanë kushtuar
Urat
Me themelet
Në gjak

A thua
Ura duan prapë

Puthe...

Puthe kryqin i pa udhë
Në gjuhë përkulu
Lërë porosinë
Poezinë ke bërë katrahurë
Mëkatar

Po uratë
Amanet
Merri të lintat e mia
Si flamur paqe
Ngritur lart në shtizë
Vegjelia të marshojë në shpërthim

Tregoju Uratë se
Ato ishin të lintat e mia
Të ndyra nga kohë e tranzicionit
Nuk ishin flamujt e revolucionit
Lënë anash kaheerë

Mëkati
Lë të bjerë mbi mua
Uratë

Ndaj hilet
Para Perëndisë
Nga të lintat tona zhele
Me ato të diplomacisë
Para BE-së
Varur në shtizë të flamurit
T'i gjendet zgjidhje e shpejtë
Njës së ushkurit

Ndryshe
Shpatë e Demokleut
Do godas
Ngarkesën e plancit të demokracisë
Në shpërthim
Diplomacia pastaj
Flakë edhe tym
Prishet paqja dhe standardi i parë
Mbetet zhele e të lintave
Para unmikut
Prapë e pa larë

O tmerr i ditës së daljes
Para perëndisë

Uratë
Pranoje rrëfimin
Për mëkatet e mia
Mbase
Na merr parasysht
Diplomacia
Amen

L I S A T E P E R G J A K U R

Parandjenjë

Armiqtë nuk po na shajnë sa duhet
Miqtë po na lavdërojnë
Më shumë se ç' duhet

Si me të pabesë
Më gërryen një ndjenjë
Ogurzezë

Satani

O trup satan
Veç krimbat të hanë
E ne kurrë nuk të shamë

Të hëngrët krimbi
Të hëngrët
Njeri
O Satan

Çmimi

Tokë e premtuar
Në ëndrrën e braktisur
Cili është çmimi yt

Arsye e humbur
Para sakrificës në mohim
E para vetes
O gjuhë memece
Në gojën e heshtur
Fjalë e papeshuar
Arsyeja çmim
Maturinë ka

Peshë e dyshimit

Në mëdyshje grinden
Ëndrrat e natës tani
Në klithje pambarim
Peshë e trillimit të sajuar
Kënaqësinë ëndrrës
Do t'ia vret

Peshë e dyshimit
Mos të bjerë kurrë
Mbi shpirtin tënd as
Mbi shpirtin tim
O miku im

Lisi

Të vetmin lis e prenë
Fshehurazi
Në zhgërryerje të paparë
Si mbi mitet e vjetra
Përcjellur tinëzisht
Mbi lisiin kishte goditur
Dorë e vrasjes së dyfishtë

I lashtë ishte lisi
Më i lashtë se fisi
Lashtësitë po vriten
Në Kosovë
Lista
Prapë
Po rriten

Trazim

Me ndërgjegje të trazuar
Kaq herë kam provuar
Sinqerisht
Kam vrarë mendjen
Netëve të gjata
Neveritë që si mbanë letra
Mendimet m'i kanë ndrydhur
Mbi mundësitë e mia
Nuk dola dot

Një buzëqeshje e ftohtë
Mbeti
Si dhuratë

Ironi e verdhë

Vargu im
Eja të ikim larg

Zilia mes vargjeve
Ka rënë
Vargjet pezëm kanë zënë
Smirëzia në garë
Ikim
Se u bëmë përrallë

Mes njerëzve urrejtja
Futur kaq thellë
Ironi e verdhë
Ikim

Kuisin qentë

Idilikë e ngatërruar
Cilën maskë ma ke vu sot
I bindur para teje
Po edhe indiferent
I humbur mes yjesh
Dikush shpirt po jap

Po kuisin qentë

Qeni në kuisje
Ende pa mbaruar
N'idilë
Këngën po ma vret
Po kuisin qentë
Korba
Për kokën e vet

Gjithmonë

Mes fjalës e keqkuptimit
Një ngushëllim i vogël
Gjithmonë

Mes shtirjes e virtytit
Shqetësimi si fryt
Gjithmonë

Kungulli mbi ujë nuk shkon
Kanë thënë
I ndershmi të nderon
Gjithmonë

Anonim

Ta imponuan vullnetin
Vërtitje kuajsh pa zot
Ujq e çakej ndër male
Ulërijnë për ty
Anonim

Kush të adhuronte si hyjni
Rrufë e mbaruar
Fanatik i mendjelehtësisë
Analogji jo bindëse
Zgërdhima mes zemërimit
Plagën e mbyllur
Rihapë

Anonim

Barrëse

Fjala mori dheun si era
Qeveria qenka me barrë

Në kuvend
Në rend të ditës
Kërkesë e opozitës
Për kohëzgjatjen e shtatzënisë
Dhe atësinë e fëmijës

Duam sqarim
Menjëherë
Ndryshe Kosovës do t'i mbes
“Me ligj”
Kopili në derë

LIRIKË SHPIRTËRORE

Nënës

Në kujtim të pritjeve të saja të gjata
Kur kthehesha
Nga rruga
Nga shkolla
Nga burgu
Nga mërgimi

Tani kush do të më pres
Nëna nuk është më
Vetëm kujtimet

Atë
Dhe tokën shqiptare
Nënë
Thërras

Rezonancë

E kemi thënë
Sa herë
Po e themi prapë
Rezonancë pozitive
Asgjë më shumë nga jeta
Veç të vërtetës
Që sfidon

Pasaktësi

Intrigë e perealizuar
Mbi vdekjen e tij imorale
Të imagjinuar

O perlë idilike
Si nuk ta këndova dot
Këngën mortore
Në ritualin tënd të fundit
Betoveni do të merrte pjesë
Me notat e protestës
Në mënyrë virtuoze
Pasaktësi që kushton
Nota që flasin deri në zbehje
Këngë në zanafillë
Përgjysmë lënë

Fjalët

Këmbëngulje
Në të vërtetën
Mos lejo
Të të poshtërojnë

Fjalët
Peshë çojnë
Ka rrugët e veta
Jeta

Halli

Si t'ia bëj me ty
Të te vras
Nuk mundem
Të te dua
E vështirë
Halli me peshën e vet me shtyn
Të gjej zgjedhjen më të mirë

Dilemë
Hallet më rëndohen
Në emër të jetës
Më mirë
Preni rrugën vdekjes

Ata që gurë në jetë vunë

Mos vë gurë në jetë
Se të vrasin ata
Me të pabesë
Sa personazhe të vdekura
Kanë lozur
Jetën në sprovë duke vënë
Në thellësitë e shpirtit
Kandili i shpresës
U shua
Do vdesin me pahir
Ata që gurë në jetë vunë

Goditje

Më goditi vështrimi i saj

Me erë
Aromë
Puhizë
Frymëmarrja më tradhtoi

U hamenda
S'u përmbajta
Nga urrejtja apo dashuria
Mbase
Nga të dyja

Nëpër kohë

Si në ëndërr kaluan
Nëpër kohë vitet

Si një patkua kali
Varur mbi derën e vjetër
Kujtimet mbetën

Fat i varur në gozhdë
Jeta nuk është vetëm shpresë
Lini gjurmët tuaja
Nëpër kohë
Njerëz

Fatalja moderne

Nga njeriu i sotëm
Morali u nda
Prostitucionalisht rënë
Në trotuarin e ndyrë
Fatalja moderne
Pjesëz e tërësisë
Panjerëzisht thyer
Mbi kurrizin tonë

Kaltërsi

Kaltërsi e syrit tënd
Si kaltërsi deti
Do të futem në thellësi
Të vërtetën
Për ta gjetur

Sy

Kaltër
Sy
Patrembur

I urryeri

Sa herë që bie për të fjetur
Lutet ajo
As në ëndërr mos të të shoh

Njeri i urryer
Zemër në plasje
Ti ëndrrat e ardhmërisë trazon
Vetëm lutja
Nuk mjafton

Syzeza

Mbi vegje mbeti syzeza
Fatziun duke e qarë
Fijet e pëlhurës u këputën
Në rrugën e shpresës së humbur
Ëndrrash kallë

Pëlhurë e bardhë
Dërrasë e vekut
Kthyer në dërrasë varri

Syzezë
Në botën përtej lotit
Fat tjetër kërko

Ndaras

Ka kohë e vite
Qe shpirti ndarë
Nga trupi
Jeton

Me shpirt në Kosovë
Me trup larg saj

Në buzëgrykën e një pusi
Të pafund
E në vaje
Ngulur trupi im

Si idhujt pa koka

Na hëngri

Toka

E huaj

Këmbëngulje

Nuk u bëre kurrë një me qetësinë

Jeta e lidhur me këto male

Madhështi shpirtërore

Që të ngacmon

Për të mësuar

Diçka për të gjallët

Diçka për të vdekurit

E diçka

Për ata që do linden

Një ditë

Këngë

Këngë e vaj

Ekuacion me shumë të panjohura

Për pëllumbat e bijve tanë

Në fluturim rënë

Kënga për ju u këndoftë

Kurrë mos u shoftë

Kurrë

I sinqertë

Dua të jam me ju

Krejt i sinqertë

Për dëshirën tuaj

Për kënaqësinë time

Përcillja të ligut

Mesazhin

E këngës sime

FALNI LIRIKAT

Fali

Të “shanë”
Faqe pjeshkë të thanë
Ti u skuqe
Moshë e re

Moshë pa mëkate
Fali çunat që të “shajnë” nga lakmia
Të padjallëzuara ka sharjet rinia
Fali

Portret

Nga dorë e piktorëve modern
Të kohës antike
Portretizuar fytyrë e pa skuqur
E sakrificës në këmbëngulje
Të hije zisë a bukurisë mitike

Monalizë moj mike
Gënjeshtër apo
Realitet
Buzëqeshja jote
Në portret

Ndryrë
Brenda kornizës në shekuj
Histori e pazbërthyer e artit
Mbi mjeshterin e penës së vjetër
Varur në maje të gozhdës
Si testamenti
Në letër

Çmallje

U çmalla në soditje
Pusi i zura
Shtegut të retrospektivës
O kohë e pa djallëzuar
Ndjenja të papërsëritshme
Ti ike
Çmallje me portretin tënd
Moj mike
Ti kohë në ikje

Dashurisë

Ndër shekuj i kënduan
Faraonë
Perandorë
Mbretër e Presidentë
Për ty ngritën tempuj
E nuk të përjetësuan dot

Prapë do t'i këndojnë dashurisë
Si dje
Sot e mot
Zanoret e dashurisë
Rimën kanë në gji

Ndarje

E dhimbshme
Por
Paqësisht dua të ndahemi
Pa lot
Nga kjo botë

Kujtimet e mikut mbani
Besnikërisht
Mos e shani gabimisht
Po sinqerisht

Ai iku

Ylberi

Shumëngjyrësh shkëlqimin
Frymëzim
Poetësh
Piktorësh
O premtim i rremë
Qe dukesh e zhdukesh
Në horizont
Pas shiut e para diellit
Shterpësinë polle
Në ditët e prillit
Në kapërcim

Malli

Formulë e pa zbërthyer graviteti

As Njutni mendjehollë
Nuk e gjeti

Mes mollës dhe tokës
Fuqi e mallit të nënëlokes
Që të stepë

Mburravec

Më thoni poet
Vetullën e hënës e keni parë
Po deshët ua tregoj unë
Në grushtin tim
Leshin e saj

Kosovë fitove mbi leshin
Sihariqin ta sollën shpejt
Thurni këngë
Këngëtarë
Për leshin
Në garë

Ironi e ftohtë

Shkretëtira shterpë
Qiellin ka ngrirë
Njeriu fytyrë vvarë
Ironi e ftohtë
E një jete
Për një grusht pleshta
Lidhur pas humbëtirës
Me fijet e padukshme
Të shkretëtirës

Botë poetike në kërkim
Të rimës së verdhë
O miku im poet
Thurë kot
Këngë në shkretëtirë
Kot

Shkëlqim i një malli

Më zgjoi çuditërisht një mall
I magjepsur nga shkëlqimi i rremë
Qiellin frikshëm shikova

Ngrohtësinë e trupit të saj
Në shtratin e ëndrrave të mija
E ndjeva

Jo s'e takova

Një zhurmë më lehtësoi mendimin
Trajektore replikash
Në dilemë
Për fjollat e shkrira të borës
Në sa po fillim të dimrit
Si ëndrrat tretur

Ringjallje

Herë i vdekur
I ringjallur herë
Fytyrat e tyre jeshile e të dyllta
Të përqendruara në mospërfillje

A do ta gjente arsyen
Qyshkur të humbur
Në mjegullën e hyjnive
Bashkë me bulëzimin e pemëve
Në drurin e kryqëzimit
Një ringjallje

Po ndihet afshi i pranverës

Ikja e zogjve

Motive vjeshtore në pikturë
Nga ikja e zogjve në fluturim
Mbi detin me shkumë
Peshë e shikimit
Drejt arave të mbjella
Me ëndrrat joshëse të lumturisë
Premtuese tinëzare

O të padjallëzuar në kusuritje
Të llogarive të vonuara
Prej një komedie
Që në dramë u shndërrua
Kur zogjtë ikën në pa kthim

Lirikë

Dashuri herë tragjike
Herë lirike
Kush troket në derën e
Lirikave të mia
Nga gjurmët e jetës lënë
Në rrugët e saja të gjata
Mendim i pa thënë

Mes dhëmbësh përtypur dëshirë
Arkitekturë e mendimit
Kontrast kundërthënës brenda
Mjeshtërisë së ndërtimit

Lirikat e mia
Lagur me ujë
Lagur me djersë
Lagur me verë
Lirikë në ekzekutim
Thjeshtësi e fjalës
Kuptimin se humbe kurrë
Lirikë e shtrenjtë
Rini e vendit tim

Servilizëm

E duartrokiten gjatë
Në mënyrë frenetike
Me dashje servilizmin mbysnin
Në duartrokitje

Shuplakë e dorës u dogj
Nga skuqjet e duartrokitjeve
Servilizmi u poq
Se bashku me vesin
As sot
Nuk u hoq

Përrallë

Ëndërr e përrallë
Një trazim
Në ndërrimin e stinës
Si në mjegull
Aterroi përralla
Mbi aeroportin e Prishtinës

Së vjetër

Përrallë e lashtë e lotëve
Të lëndinës
Tani
Një kujtim i ripërsëritur
Mbi aeroportin e Prishtinës

R I M A T H A K M A R R Ë S E

Urrejtje

Ai u fut në Parlament
Me kokrrën tënde
E fare qetë
E hodhi në votim
S'ka as edhe një pëllëmbë tokë
Për themelet e shtatores së lirisë
Në Prishtinë

Hakmarrje

Hije e tij më vret
Vuajtja mbi te
Të përligjet
Ndryshe
Do të vuaj përjetë
Po nuk i godita
Llahtarit e kohës
Së çmendur

Poshtërim

E rëndë ndarja
I rëndë loti
E rëndë fyerja
I rëndë harrimi
Më i rëndë
Poshtërimi
Në prapaskenë

Rënie

Bora ra nga maja e malit

Mbi faqe
Gjurmë la

Loti i rënë
Nga gjethi i lisit
Si rënia e Sizifit
E domosdoshme mbase

Asfalti

Asfalt i zi katran
Të shkel bota
Me këmbë
Bota shumëngjyrëshe
Të shkel
Asfalt i zi katran
Shkelja është e rëndë

Durimi

E keqja të është bërë ves
Tërë ditën gogësinë
Nga të ngrënat e hershme
Nuk lirohesh dot
Sa shumë paske ngrënë

Po unë ç' faj kam
Që gogësimat duroj

Të marrët

Për të vetmin gabim
E “dekoruan” me titullin
„I marrë“

Për gabime të shumta pastaj
Është djallëzor thanë

Sa më i marrë
Aq më djallëzor

Teori e filozofisë aktuale në Kosovë
„Djallëzorët“ pa brenga
Qeverisin e rrojnë

Jetë e fotokopjuar

(Apologji e Sokratit)

Dëshiroj
T'i shoh pas vdekjes njerëzit
Si do të lozin
Rolin e tyre
Në jetë
Apo në skenë më mirë

Sokrati vdiq
Hilet e jetës vazhdojnë
Sokratianët
Sot
Jetën fotokopjojnë

Formëdhënësit

Amorf
Formën të tjerët ua japin
I bëjnë legen
I bëjnë tigan
Në njërën pështyjnë
Në tjetrën hanë

Reformë

Hipokritët nga ne
Kërkojnë
Formën e robërisë së reformuar
Ta kuptojmë

Në mes formës dhe reformës
Alegori e metaforës
Dinakëri e fshehur
Në brekët e Evropës

Partitë

E djathtë
E majtë
...
U përlij kjo punë
Përmes përkatësisë partiake
Identifkohemi
Në fytyrë
Në serrat

Me shterpësinë e gjatë
Kancerin morën
Në stomak

Standardet

Për vjetërsi
Vezën dhe pulën
Në garë i vunë
Në lavatriqe
Futen llumin
E sistemit të kaluar
Na doli më pas i „larë“
Nga inkubatori
Hibridi i provës së parë

Patriotë të shëmtuar
Kategori e ripërpunuar
Standardet
Plotësojnë

Zbulim

Qeniet e botës ngjajnë
Kanë tiparet që i bashkojnë
Njeriu majmuni dhe zagari
Nuk bajgëlojnë
Eureka
U gjet emëruesi i përbashkët

Për kohën e kashtës

Kohë në vardisje
Hip në mullarë e shiko hamamin
Se vakti kashtën ha
E tmerrshme
Apoteozë kashte
E ditëve tona

Kripë

Gënjeshtrës kripë i vunë
Në dritën e syrit
Kripën e Nastradinit
Shije për t'i dhënë
Shpresës së mjerimit

O ju të pa fat
Me lotin e kripur
Në rrugën e gjatë
Të gjatë

Trung

Trung pa rrënjë
Që në punë
S'i hyre kujt
As dje
As sot
As mot
Trung kot

Ligji

Ligjin e bënë ata
Kundër të tjerëve
Iku arsyeja
Kush pjerdh për drejtësi
Para ligjit e njeriut
Skuqet kush sot
Më thuaj
Sa kushton hileja

Tradhtia

Një orë para se ta tradhtonte
Befasisht i tha ajo

Të dashuroj

Të vetmen gjë që nuk e priste
Nga jeta
Ishte tradhtia
A thua erdhi ora
E qetësisë shpirtërore

Një orë para se ta tradhtonte
Tha ajo
Të dashuroj
Vallë
Sa është i thellë lumi
Mes dashurisë dhe tradhtisë

K O M E D I E B A L A N C U A R

Shqip

Po ju paralajmëroj për të satën herë
Qetësi
Kjo inteligjencë e arrestuar
Tani flet të vërtetën
Pas derës së rëndë të hekurt
Në atë gropë
Flitet shqip

Në fantazinë e tyre
Ka diçka madhështore
E rëndë pa dyshim

Edhe një herë
Paralajmëro inteligjencën
Flisni shkurt dhe shqip
Mbroni të vërtetën

Sakrificë e imagjinuar

Si të maces shtatë shpirtra
Paske pasur
Sakrificë e imagjinuar
E intrigave sublime
Mohuesja e çdo gjëje
Mortaja e lia t'vraftë
Mace me shtatë shpirtra
Me yshtjet tuja të ndyra
Në plehurat e qyteti
Të kësaj pranvere pjellore
Vdekjes prapë s'iu deshe
O vdekje horre

Llogari

Mos kërko nga unë
Atë që të mungon ty
Joshje në vetëmashtrim
Se koha
Do të na vret më shumë
Pa dyshim

Llogari mos më kërko
Shumëzimi
Mbledhja
Pjesëtimi
Me hiçin
Hiç rezultatin ka
Llogari mos kërko

Teatër

Para teatrit
Kompozim ngjyrash
E personazhesh
Të dëshpëruar
Me egon vulgare
Me ambicie meskine
Aktrues të mohimit
Antivlera të mbështjellë
Tërkuzë
Pasionistë të sëmurë
Cilën dramë po përgatisin
Për publikun shqiptar
Mos
Prapë „Godonë“ vallë

Silikoni

Bastardët e menduan
T’ia venin silikonin në gji
Kosovës nënë
Që të mos i zë mallkimi
I saj në zemërim

Haram ju qoftë silikoni
I gjinjve të mi

Bastardët shpëtuan
Silikonin zbuluan
Rrejshëm në Hagë
Dëshmuan

Pa frikë nga mallkimi

Karriget

Si orendi në Parlament
Karrige shumëgjyreshe vunë
Të zbrazen nga vreri
Deputetët

Në karrige të parin vunë
Me legen në duar
Për të mbajtur radhën e zbrazjes

Respektoni radhën tani
Ju vrer zi
Ngacmuesi i vrerit ju fton

Mortaja

Për vendin vakant
Kambana e përmbysjes së madhe ra
Nga shoqëria vakante u dogjëm
Tautologji e stërzgjatur
Mekje pranverore
Minjtë e mbeturinave të qytetit
Mortajë po përhapin
Kurthi s'po i zë
Në kurth
Pa (me) dashje
Kemi rënë ne

Kosova

Po të ishte vetëm imja
Do ta mbaja nën xhaketë
Mos ta kapën alergjia
Nga poleni i pavarësisë
Të paktën edhe këtë vit

Gogoli ynë
Po frikëson sorrat
Në stinët pranverore
Me koqet e dashit
Varur në degën e qershisë
Për t'i vënë më vonë
Në shenjë flijimi
Në themelet e pavarësisë
Kosovë
Me fat

Gëlltitësi

Se bashku me gotën
E verës së zezë
Gëlltiti
Vezën e pulës kllloçkë
Që në embrion
Vezën me gjithë zog

Përtej grykësisë
Çka mund të ketë

Kodoshët

Përulen ata
Para brekusheve të kuqe
Të një lavireje në kalim
Si para flamurit të lirisë

Jemi burra
Thonë

Alibi e burrërisë
Prej kohësh
Në baltë rënë

Elegji

Gjaku e lanë
Kush prek gurin e avllisë
Tha

Ai vdiste për tokën
Dy hapa rreth shtëpisë

Vallë
Bijtë e Shqipnisë qenkan -
Pyeti me qortim
Vaso Pashë Shkodrani
E pikllueshëm rënkoi
O moj Shqipni

Abuzim

Në emër të ekzistencës
Për hir të kombit

Në emër të zotit

Kush abuzoi
Me të gjallët
Me të vdekurit
Me jetën

Baladë moderne e ujërave të zeza
Në përplasje vërsulur
Në qytet mbi kalldrëme
Nëntoka
Nuk i mbanë dot

Kopshtarët e atdheut

Kopsht me fjalë ndërtuan
Pallate mbi shtatin e atdheut
Ulur mbi postaqinë e iriqit
Burrat e politikës
Për hir të elektoratit
Prapanicën po sakrifikojnë

Qëndron e pa tundur
Bythë e larë në gjak
Me postaqinë e iriqit
Elektorati po merr hak
Tagrin posti
E ka të lartë

Ati ynë pat thënë
Të ngrohet hamami me pordhë
E të pastrohemi
Se u bëmë horë

Koalicioni

Që kur bota mbanë në mend
Ujku me qengjin
Pula me dhelprën
Miqësi nuk kanë zënë

Atëherë
Mbi kë do të bie fatkeqësia
O arkitekt i dredhive të liga
Ti nuk je
Pasha Sinan

Fantazi perfide e dredharakëve
Me foshnjën e pafajshme në gji
Mashtruesit
Këtë vit
Bënë në prapa hije kumbaritë
Thellësisht fshehur
Në gjoks
Pabesitë

Hundët

Ata që futin hundën
Pa ftuar
Sa pa thënë
Vishni me përgjegjësi

Në mes përgjegjesisë
Dhe llogarisë së pa dhënë
Thikë me dy teh
E u N m I k- U t
Pehlivanët dot nuk i kapë
Prapanicat me vaj kanë lagë

NARRACION NË HUAZIM

Pluralizmi

Sistemi shumë partiak
Ta mat e s'ta japë
Një bythë karrige
Lavire politikë

Arsyetim i gabuar
Folklorizëm prapanik
Thuaj po deshe tani
O lavire politikë

Ai

Rrugën gaboji me dashje
Nga shokët iku
Nga shokët nuk kërkoi falje
Ndarje

Në theqafje

Pa kohë e në trishtim
Iku
Në të pa lindurin agim

Kontratë

Kontratë imorale
Absurde
Me kampin e dëshirave të lakmisë
Projekt dallgësh të ngritura
Në mes luhatjeve rropullish
Simetrinë e dyshimit
Zgjedhje në orën e ligë
Or miku im

Shkëlqimi i çastit
T'i verboi sytë fatalisht
Rrëshqite nga lartësitë e zenitit
Se bashku me lakminë
Pas hiç gjësë
Në gërminë

Bijtë e kotësisë

Në pamjen e jashtme
Po t'i shikosh
Të duket
Secili me vete bartë
Nga një histori

Dilemë për pak çaste
Vrasje e butë me çaj e duhan
Dënim absurd
Pajtim me shëmtitë
As gjë nga jeta
Nuk kërkojnë

Eliminimi

Bartur fshehtas
Nga sirtarët
E diplomacive të mëdha
Në krihet e Kosovës ra
Virusi i eliminimit

Me shëndet

Mbiu në Kosovë
Druri i pasigurisë

Reliev i thyer
I dyshimit gjeografik
Mes rrugëve dhe njerëzve
Virusi i dyshimit
Si thikë

Duka

Duka i Gjinëve të parë
Hije vvarë
Nga peshë e barrës së rëndë
Të shekujve lakuriq
Lesh parruar
Kokë pa kruar
Me mospërfillje u fut
Në pallatin e ëndrrave
Ndonëse zgjuar ishte

Kur të zgjohet Duka
Nga ëndrrat e shtratit të shekujve
Testamentet e ëndrrave
Kujt do t'i mbesin

Kujdes Gjin Duka
Nga shtrati i ëndrrave
Me pupla të buta
Kosovën e vranë ndër shekuj
Me gjak
E
Me pupla

Dështim

Dështove pjellën e parë
Të thonë shterpë tani
Nuk je më me barrë
Dështak

Ti nuk ke faj
Mes të dështuarve
Pritja është e gjatë
E thatë

Nështrimi para fatit

Kohë e kaluar
Po rikthehet në skenë
Me pelenë mbështjell
Fytyrën e mjerë

Nështrim para diktatit
Sakrificë e rëndë
Futin hundët në pelenë
Ju të parë
Të nështruar para fatit
Në gjuhë rënë

Varje

Nga fijet e mjekrës tënde Pasha
Po zë fill tërkuza
Mbi sfondin e jeshilët
Në vertikalen e paskajoreve
Heshtat helmuese u përthyen

Pabesi kujt i ke ngreh
Pasha i verdhë
Pabesi
Rrënjët ku i ke
Makthi në gjumë të vraftë
Pasha

L U M I N (S) K A L U A N

Unitet

Gjyshja ime ndjesë pastë
Me dorën e saj të lehtë
Nga shtëllunga e leshit
Fijet i lidhte në unitet

Njerëzit e kohës moderne
Si grykësit që zihen për një presh
Unitetin e kohës së vonuar
Prapë e bënë lesh

Leshi e lëmshi u ngatërruan
Në fushat e gjera të interesit

O gjyshe ime e mirë e ndjerë
U dhje ndër vete
Uniteti ynë prej leshit

Dikur dhe tani

Dikur
Kur lumin kalonin të ligjtë
Atkinë ta shanin
Tani kur lumin kalojnë
Atkinë
Më nuk ta shalojnë
Më keq
Nënë ta lodrojnë
Oho ç'kohë të mbara
Me të shara e të pa lara

Premtim

Premtimin e thatë
Po e han
Tri herë në ditë
Populli im në pjatën e pistë
I bëftë mirë

Imagjinatën e shterpës shpresë
Tmerrësisht ftohur e në ethe
Shëroje o popull im pjellor
Futja një medikament
Të skaduar nga mbrapa
Premtimit
Edhe nga një pordhë
Me shëndet

Medaljoni i ndryshkur

Prej kohësh mungojnë
Sfiduesit e tij
Në qafë të kujt do ta varim
Atë teneqe me tojën e leshit

Në qafë të paçin Kosovë
Qafë-tojë-leshtit
E teneqe-medaljon-punuesit

Gënjeshttrat ndryshku do t'i hajë

Ah
Kjo do zgjas shumë
Erë ndryshku e servuar
Pritjen do ta vras
Ngadalë e
Pa shije

Njeriu

Sinonim i dashurisë
Personifikim i urrejtjes
Veç njeriut- njeriu
O njeri
Më thuaj
Cili je ti

Zagari

Shkencëtarët në kërkim
Gjetën zagarin dhe njeriun
O njeri zagari
Me pagëzim të ri
O zagari njeri
I thanë
Atij

Vdekje banale

Haxhi Imam Efendi
Për heronjtë e moderuar
Duam përjetësi
Cilën vdekje preferoni
Haxhi Efendi

Vdekje nga duhani
Rënie nga ballkoni
Rrëshqitje nga hamami
Nga smira e xhelozia
Nga vera e rakia

Mbase
Me vdekjen diçka
Ata duan të zënë
Diçka
Jetë e rrejshme
I rrejshmi njeri

Efendi Haxhi

Mashtruesi

Te jetë ai vërtetë
Ndërtuesi i kështjellës

Unë
Nuk e besoj
Nuk e beson as ai vet
Veç shtiret
Na hëngrën pritjet e gjata
Kështjellë
O mbetsh shkret

Gërmim

Në mes britmash dhe çjerrjesh
Çmenduria

Vuajtjet mos gërmo
Pagjumësi do marrësh
Në pa skajshmëri
Prapë nga e para
Do fillosh
Me fijen e lëmshit të ri

Dyshim

Vdiq në vetmi ajo
U shua së bashku
Me flakën e kandilit të saj
Që e mbante në dritare natë vonave

Në shkëlqimin mitizues
Për “profetët”
Dyshonte
Nuk besonte
Dritë kërkonte

Gjysmë

Në atë gjysmë terr të asaj nate
Atje përtej ku po gdhinte
Sytë e tu gjysmë të mbyllur
Në gjysmë buzëqeshje

Heshtje gjysmë e pabesë

Në jetë diellin takuam
Trullosje e pashpresë
Gjysmë lagur me vesë
Gjysmë ëndërr
Gjysmë zgjuar
Gjysmë robëruar
Gjysmë çliruar
Gjysmë
Pjesë e tërësisë
Së pa bashkuar

Shënime për autorin

Mehmet Bislimi, publicist dhe poet nga Prekazi, lindur me 1958, i burgosur dhe i përndjekur politik, emigroi në Zvicër në vitin 1994, ku edhe jeton e vepron përkohësisht. Botoi poezi dhe shkrime të shumta në gazetata shqiptare në perëndim, herë pas herë shkruan edhe në gazetën “Epoka e Re” me botim në Prishtinë. “Ironi e verdhë” është libri i pestë i tij – respektivisht i treti me poezi.

Përmbajtja

Fjala e redaktorit7

EPIKË E PËRFLAKUR

Emblemë.....	11
Ishull	12
Prizmi i dyshimit	13
Tradhtinë vari	14
Në ballë të oxhakut	15
Rrugët	16
Flakët	17
Dilemë	18
Pikëpyetje	19
Një pëllëmbë truall	20
Fehmi Ladrovci.....	21

UNIVERSI NË KORNIZË

Kryqëzim	25
Shkëlqimi që vret	26

Shtegu	27
Muranat	28
Rigjykim	29
Rimat	30
Nihilisti	31
Uji	32
Plaku	33
Dhuna	34
Kufiri	35
Dëshirë	36

TRISHTIMI I SHEKUJVE

A do karrocë zotëri	39
Katarsis	40
Daujja	41
Divorcimi	42
Heshtje	43
Përballim	44
Vrasje e trishtimit	45
Projekt	46
Pa dashje	47
Burrëri	48
Ura	49
Puthe... ..	50

LISAT E PERGJAKUR

Parandjenjë	53
Satani	54
Çmimi	55
Peshë e dyshimit	56
Lisi	57
Trazim	58
Ironi e verdhë.....	59
Kuisin qentë.....	60
Gjithmonë.....	61
Anonim	62
Barrëse.....	63

LIRIKË SHPIRTËRORE

Nënës	67
Rezonancë	68
Pasaktësi	69
Fjalët	70
Halli	71

Ata që gurë në jetë vunë	72
Goditje.....	73
Nëpër kohë	74
Fatalja moderne	75
Kaltërsi	76
I urryeri	77
Syzeza	78
Ndaras.....	79
Këmbëngulje	80
Këngë	81
I sinqertë	82
FALNI LIRIKAT	83
Fali	85
Portret	86
Çmallje	87
Dashurisë	88
Ndarje	89
Ylberi	90
Malli	91
Mburravec.....	92
Ironi e ftohtë	93
Shkëlqim i një malli	94
Ringjallje	95
Ikja e zogjve	96
Lirikë	97
Servilizëm	98
Përrallë	99

RIMAT HAKMARRËSE

Urrejtje	103
Hakmarrje	104
Poshtërim	105
Rënie	106
Asfalti	107
Durimi	108
Të marrët	109
Jetë e fotokopjuar	110
Formëdhënësit	111
Reformë	112
Partitë	113
Standardet	114
Zbulim	115
Për kohën e kashtës	116
Kripë	117
Trung	118
Ligji	119
Tradhtia	120

KOMEDI E BALANCUAR

Shqip	123
Sakrificë e imagjinuar	124
Llogari	125
Teatër	126
Silikoni	127
Karriget	128
Mortaja	129
Kosova	130
Gëlltitësi	131
Kodoshët	132
Elegji	133
Abuzim.....	134
Kopshtarët e atdheut	135
Koalicioni	136
Hundët	137

NARRACION NË HUAZIM

Pluralizmi	141
Ai	142
Kontratë	143
Bijtë e kotësisë	144
Eliminimi	145
Duka	146
Dështim	147
Nënshtimi para fatit	148
Varje	149

LUMIN (S) KALUAN

Unitet	153
Dikur dhe tani	154
Premtim	155
Medaljoni i ndryshkur	156
Njeriu	157
Zagari	158
Vdekje banale	159
Mashtruesi	160
Gërmim	161
Dyshim	162
Gjysmë.....	163
Shënime për autorin	164

Tirazhi

500 copë

Formati

140 x 200
Prishtinë 2005